

L I G J
Nr. 8674, datë 26.10.2000

PËR RATIFIKIMIN E AMENDAMENTIT TË "TERMAVE TË PËRGJITHSHME TË 7 MARSIT 1994", NËNSHKRUAR NDËRMJET KOMITETIT QEVERTAR PËR BORXHIN E JASHTËM DHE OESTERREICHISCHE KONTROLLBANK, AG.

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet amendamenti i "Termave të përgjithshme të 7 marsit 1994", nënshkruar ndërmjet Komitetit Qeveritar për Borxhin e Jashtëm dhe Oesterreichische Kontrollbank, AG.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2778, datë 3.11.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

AMENDAMENT

i termave të Përgjithshme të 7 Marsit 1994

ndërmjet përfaqësuesve të Komitetit Qeveritar Shqiptar për Borxhin e Jashtëm, i cili vepron për dhe në emër të Republikës (më poshtë Shqipëria) dhe Oesterreichische Kontrollbank AG, Vienna, që vepron si agjent i Republikës së Austrisë (më poshtë "OeKB")

1. OBJEKTI I AMENDAMENTIT

Objekt i Amendamentit është shtyrja e detyrimeve të borxhit mbi bazën e Termave të Referencës mbi Riorganizimin e borxhit të Republikës së Shqipërisë, të Tetorit 1999, të quajtura më poshtë Termat e Referencës (Aneksi 1).

Ky Amendament është pjesë e pandarë e Termave të Përgjithshme të 7 Marsit 1994, klauzolat e të cilave mbeten në fuqi të plotë, pas nuk ndryshohen dhe nuk preken nga ky Amendament.

2. ZBATIMI

Procedurat teknike të shtyrjes së borxheve janë si më poshtë:

- a) Përfundimi i këtij Amendamenti të Termave të Përgjithshme të 7 Marsit 1994 me OeKB mbi termat e shtyrjes dhe
- b) Përfundimi i një Amendamenti të Marrëveshjes së kredisë të 7 Marsit 1994 me Erste Bank der osterreichischen Sparkassen Ag (ish GiroCredit) (Aneksi 3).

3. SHUMAT E SHTYRA DHE TERMAT E RIPAGIMIT

Borxhet për të cilat do të zbatohet shtyrja janë si më poshtë:

- a) 100% të shumave të principalit dhe të interesit (përfshirë interes - vonesat) që duheshin paguar deri më 31 mars 1999 dhe që nuk janë paguar dhe 100% e shumave të principalit dhe interesit (pa interes - vonesat) që duhen paguar nga 1 Prilli 1999 deri në 30 qershor

2000 (përfshirë) dhe që nuk janë paguar, të cilat rrjedhin nga Llogaria e Marrëveshjes së kredisë së 7 Marsit 1994 (Neni IV, paragrafi 4.01).

DATA E MATURIMIT PRINCIPALI NË EUR	INTERESI NË EUR
30.09.1999	37,212.90
31.12.1999	839,767.67
31.12.1999	39,803.35
31.03.2000	29,803.35
30.06.2000	1,007,721.21
30.06.2000	31,586.46

b) 100% e interesit nga 1 prilli 1999 deri më 30 qershor 2000 (përfshirë) të llogaritur mbi shumat që do të shtyhen sipas pikës 3.A.a), do të kapitalizohet në 30 qershor 2000.

B. Pagesa e shumave të shtyra për të cilat bëhet fjalë në nenin 3. A. do të bëhet në 10 kështe të barabarta gjashtëmujore:

30 Qershor 2001	31 dhjetor 2001
30 Qershor 2002	31 dhjetor 2002
30 Qershor 2003	31 dhjetor 2003
30 Qershor 2004	31 dhjetor 2004
30 Qershor 2005	31 dhjetor 2005

C. Shuma e përgjithshme e detyrimeve të shtyra nuk do t'i kalojë 2,100,000.00 EUR (kundërvlefë e 28,896,630.00 ATS)

4. MONEDHA

Monedha e Marrëveshjes së kredisë është euro.

Duke filluar nga 1 janari 1999 Austria, si anëtare e Bashkimit Europian, ka futur euron si monedhë të përbashkët. Kursi i këmbimit i fiksuar më 31 dhjetor 1998 është 1 EUR = 13, 7603 ATS. Nënkuptohej se të gjitha shumat e përmendura në këtë Amendament janë në euro.

Tiranë, më 24.7.2000

Vienë, më 30.3.2000

PËR
KOMITETIN QEVERITAR
SHQIPTAR

PËR
OESTERREICHISCHE
KONTROLLBANK
AKTIENGESELLSCHAFT